

24. TWR Shpresë për ty të jenë në gjendje të rifillojnë përkthimin dhe shpërndarjen e kalendarëve të lutjes në Ganë dhe të fillojnë prodhimin dhe transmetimin e Shpresë për ty në gjuhën Tui.

25. Mijëra gra nigeriane që rrëmbehen dhe abuzohen nga trafikantët në Libi, ndërsa përpiqen të zhvendosen në vende ku mund të gjejnë punë për të ndihmuar në sigurimin e nevojave të familjeve të tyre.

26. Udhëheqësit e kishës që t'i mësojnë burrat të respektojnë dhe mbrojnë gratë dhe vajzat. Lutuni që gratë dhe vajzat adoleshente të respektojnë veten dhe të mos lejojnë meshkujt t'i joshin, duke kërkuar që burrat t'i trajtojnë me dinjitet, të marrohen me ta dhe të sigurojnë për familjet e tyre.

27. Disa gra besnike në Republikën Demokratike të Kongos që luten me ne edhe mes shkatërrimit të tmerrshëm të sjellë nga disa konflikte në komunitetet e tyre. Lutuni për paqe, kështu që miliona njerëz të zhvendosur të mund të kthehen në Kongo për të rindërtuar jetën e tyre.

28. Gratë që jetojnë në Mali, ku varfëria ekstreme dhe shkalla e lartë e analfabetizmit e bëjnë jetën shumë të vështirë. Lavdëroni Zotin për 22 radiot në Mali që transmetojnë Shpresë për ty në gjuhën Bambara.

29. Prekjen e vazhueshme nga Perendia të zemrës së thyer, të frikësuarit, të vetmuarit, dhe të dëshpëruarit. Dashuria e tij e madhe i fton gratë të marrin gëzimin dhe paqen e Tij pa marrë parasysh se në çfarë rrethanash ato janë. "Emri i Zotit është një kala e fortë, tek ai turret i drejti dhe gjen siguri." (Proverbat 18:10).

30. Gratë e izoluar nga kontrollimi i besimeve fetare kulturore dhe fanatike që janë armiqësore ndaj ungjillit. Vetëm nëpërmjet programeve të radios që arrijnë në shtëpitë e tyre dhe pas dyerve të mbyllura, shumë prej tyre do të jenë në gjendje të dëgjojnë për dashurinë dhe dhuratën e shpëtimit të Perëndisë.

Vendet e Afrikës Perëndimore dhe Qendrore janë të pasura me diamante, ar, naftë, uranium dhe minerale të tjera, por popullsia është një ndër më të varfërat në botë. Bollëku i burimeve natyrore shpesh bëhet një mallkim dhe jo një bekim për popullin vendas. Keqpërdorimi i këtyre burimeve çon në infrastrukturë të kufizuar si shkollat, spitalet, energjia elektrike dhe shërbime të tjera, dhe kjo i irriton njerëzit që po luftojnë për të mbijetuar. Ky irritim ka çuar në shumë rebelime dhe konflikte, të cilat zhvendosin miliona njerëz dhe i lë ata të ballafaqohen me kequshqyerje, akses të pamjaftueshëm me ujë të sigurt, higjenë të papërshtatshme dhe një të ardhme pa shpresë.

Në kërkim të të ardhurave, shumë gra udhëtojnë në vende të tjera për të gjetur punë. Disa pastaj detyrohen të prostitutojnë ose të mbahen si harac derisa familjet e tyre të paguajnë për lirimin e tyre. Vajzat që ndjekin shkollat me shpresë për jetë më të mirë ndonjëherë rrëmbehen nga rebelët, shumë prej të tyre fëmijë ushtarë po kërkojnë gjithashtu një rrugëdalje nga kushtet e tmerrshme të jetës.

Gratë në këtë rajon të Afrikës shpesh vuajnë nga praktikat kulturore të prerjes në zonat gjenitale të femrave dhe martesat e fëmijëve të shoqëruar me një kujdes të kufizuar shëndetësor i cili mund të shkaktojë shkallë të lartë të vdekjes së nënave. Shtatëzanitë e shumë prej atyre që mbijetojnë vuajnë nga problemi i dobësisht të fistulës obstetrike. Përveç kësaj, sëmundjet e parandalueshme ose lehtësisht të shërueshme si malaria, diarreja dhe infeksionet respiratore mbeten vrasësit kryesorë të grave dhe fëmijëve.

Errësira shpirtërore gjithashtu kap njerëzit e Afrikës Perëndimore dhe Qendrore me frikë dhe skllavëri ndaj nuskave, magjisë vudu, mjekët magjistare, dhe kontrollin e praktikave kulturore dhe fetare. Edukimi i kufizuar ka errësuar edhe më tej jetën e grupeve të njerëzve të paarrtshëm dhe të kulturave gojore, duke e bërë të vështirë t'i arrijë ato me ungjillin e Krishtit. Transmetimet e programeve të TWR-së arrijnë në errësirën dhe dëshpërimin e tyre. Programet Shpresë për ty ofrojnë këshillë jetëshpëtuese, dashuri dhe shpresë nëpërmjet Jezu Krishtit.

Të lutemi për gratë në Afrikën Perëndimore dhe Qendrore



Dëgjoni kalendarin e lutjes online në
twr-albania.com

Dëgjoni programin "Shprese per ty" në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe

17:00



Të lutemi për...

1. Gratë në Afrikën Perëndimore dhe Qendrore të cilat përipiqen të sigurojnë për familjet e tyre edhe pse kanë pak burime, arsimim të pakët dhe pothuajse asnjë ndihmë nga familjet apo komunitetet e tyre.

2. Të lutemi që Fryma e Shenjtë e Perëndisë të ndryshojë zemrat e udhëheqësve të përfshirë në konflikte dhe rebelime në të gjithë Afrikën Perëndimore dhe Qendrore dhe t'i japë fund vuajtjeve dhe trazirave që shkatërrojnë komunitetet dhe familjet. "Unë, prapëseprapë, të bëj thirrje, pra, para së gjithash, që të bëhen përgjërime, lutje, ndërhyrje dhe falënderime për të gjithë njerëzit, për mbretërit e për të gjithë ata që janë në pushtet, që të mund të shkojmë një jetë të qetë dhe të paqetë me çdo perëndishmëri dhe nder." (1 Timoteu 2: 1-2).

3. Të krishterët që t'i ndihmojnë gratë dhe vajzat të kuptojnë sa të çmuara janë për Perëndinë, duke njohur dinjitetin dhe fuqizimin që Ai u ofron atyre nëpërmjet një jete të re në Krishtin.

4. Mbrojtje të punëtorëve dhe pajisjeve në transmetuesin e TWR Afrikën Perëndimore në mënyrë që programet Shpresë për ty në Bambara, në anglisht dhe frëngjisht mund të vazhdojnë t'i japin shpresë në Jezusin atyre që janë në dëshpërim.

5. Koordinatorin kombëtar të TWR Shpresë për ty në Republikën Qendrore Afrikane dhe për të tjerët që ndajnë dashurinë e Perëndisë me gratë në spitale dhe qendra të lindjes, ndërkohë që shpërndajnë ushqime dhe nevoja të tjera. Lutuni që gratë që janë abuzuar do të jenë të gatshme të bëjnë analizat për sëmundje dhe infeksione në mënyrë që të marrin medikamentet e duhura.

6. Gratë e Republikës së Afrikës Qendrore për t'u bashkuar me më shumë se 1.300 gra në 39 grupe lutjesh duke përdorur përkthimin Sango dhe duke u lutur në pesë gjuhë të tjera lokale (Banda, Kaba, Ngbaka, Nzakara dhe Jakoma).

7. Vullnetarët në përkthimin e skripteve "Shpresë për ty" në gjuhën Sango me shpresën se ato do të jenë në gjendje të regjistrojnë dhe transmetojnë programet në stacionet radiofonike të Republikës së Afrikës Qendrore.

8. Bekimet e Zotit mbi 30 drejtuesit e grupeve të lutjes në Liberi dhe gratë që luten përmes kërkesave mujore të lutjes, të cilat transmetohen gjithashtu nga dy stacione radiofonike. Lutuni për ato që vizitojnë kishat për të inkurajuar gratë në marrëdhëniet e tyre me Perëndinë dhe për t'i ftuar ato që të fillojnë grupet e lutjes.

9. Zemrat, mendjet dhe ndjenjat e grave të burgosura në Kamerun, Republikën e Afrikës Qendrore, Liberi, Nigeri dhe Mali që Perëndia t'i ndryshojë ato dhe t'i ndihmojë që të jetojnë për Të në rrethanat e tyre të vështira. "Kujtoni të burgosurit si të ishit të lidhur bashkë me ta, dhe ata që keqtrajtohen, sepse edhe ju vetë jeni në trup." (Hebrenjve 13: 3).

10. Gratë dhe vajzat që vazhdojnë të jenë të prekshme ndaj infektimit me HIV, dhunës gjinore dhe varfërisë, ndërsa kanë arsim dhe shërbime shëndetësore të kufizuara.

11. Udhëheqësit për të adresuar mungesën e mamive në komunitetet e tyre. Kjo mungesë çon në ndërlikimet e shtatzënisë, fistulat dhe vdekjet.

12. Dëgjuesit e transmetimeve anglisht të Shpresë për ty që dëgjojnë në Ganë, Liberi, Nigeri dhe Sierra Leone për ta ndjekur Krishtin çdo ditë dhe t'u mësojnë fëmijëve të tyre Fjalën e Perëndisë.

13. Gratë me aftësi të kufizuara për të gjetur shpresë, dinjitet, siguri personale, praninë dhe dashuri në komunitetet që i konsiderojnë këto gra të mallkuara nga Perëndia.

14. Shërbesën e TWR Shpresë për ty për t'u lidhur me gratë spanjisht-folëse të Afrikës Perëndimore dhe Qendrore dhe t'i ftojë të luten me ne duke përdorur përkthimin spanjoll të kalendarëve mujor të lutjes.

15. Nënata që të mësojnë dëmin emocional dhe fizik me të cilin bijat e tyre përballen nëse vazhdojnë praktikat kulturore të gjymtimit gjenital të femrës, e cila është e zakonshme në Afrikën Perëndimore dhe Qendrore.

16. Grupet e krishtera që ofrojnë aktivitete për gjenerimin e të ardhurave për nënat, si për shembull bujqësi dhe bërja e sapuneve, për t'i ndihmuar në pagesën e uniformave dhe librave, në mënyrë që fëmijët e tyre të mund të ndjekin shkollën.

17. Baballarët, bashkëshortët, vëllezërit, xhaxhallarët dhe burrat e tjerë që të inkurajojnë gratë dhe vajzat në familjet e tyre dhe t'i mbrojnë ato duke kërkuar që të tjerët t'i respektojnë si vajza të çmuara të Perëndisë

18. Zonjat e Bregut të Fildishtë që prodhojnë programin francez "Shpresë për ty" që është dëgjuar në Benin, Burkina Faso, Bregu i Fildishtë, Mali, Niger dhe Togo. Lutuni gjithashtu që një licencë me valë të mesme të mund të merret në mënyrë që shumë grupe të tjera të paarritura në Kamerun, Çad, Guinea, Mauritani, Nigeri dhe Senegal mund të dëgjojnë programe në gjuhët e tyre.

19. 35 grupet e lutjeve të Bregut të Fildishtë që përfshijnë 2,200 gra që inkurajohen ndërsa luten, dëgjojnë, mësojnë, rriten dhe japin ndihmë për të tjerët të njohin Perëndinë. Lavdëroni Zotin që kërkesat e lutjes në frëngjisht tani mund të dëgjojnë në Facebook ose duke përdorur kartat e memories, gjë që është e rëndësishme për ata që nuk lexojnë!

20. Vënien në dispozicion të vaksinave, antibiotikëve, suplementeve mikroushqyese, rrjetave për insektet që duhen nëpër krevate dhe praktika të përmirësuar të ushqyerjes së gjirit së bashku me miratimin e praktikave të higjienës së sigurt për trajtimin e sëmundjeve të parandalueshme që vrasin fëmijët dhe gratë.

21. Dituri dhe besim të fortë për familjet që rritin fëmijët e tyre për të kuptuar se ligjet e Perëndisë i ndihmojnë ata të jetojnë jetë të shëndetshme dhe produktive që nderojnë Zotin dhe çojnë drejt një të ardhmeje më të mirë. "Lum ai njeri që më dëgjon, duke u gdhirë çdo ditë te portat e mia dhe duke ruajtur shtalkat e portave të mia." (Proverbat 8:34).

22. Mbrojtjen e Zotit ndaj grave dhe fëmijëve të tyre teksa jetojnë me akses të kufizuar mjekësor ku malaria, tifo, ethet e verdhë dhe melingjiti janë shqetësime të mëdha.

23. Mbushje nga Fryma e Shenjtë për të krishterët që jetojnë në komunitete të zhytur në errësirë shpirtërore për shkak të ndikimeve nga fetë e tjera dhe nga praktikat kulturore si magjitet, skllavërinë e fëmijëve dhe sakrificën rituale të fëmijëve.

Të lutemi për gratë në Benin, Burkina Faso, Kamerun, Republika e Afrikës qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Gana, Bregu i Fildishtë, Liberi, Mali, Niger, Nigeria, Sierra Leone dhe Togo